



## KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA

### Procesverbal i mbajtur më 11 shtator 2024, në mbledhjen e XXVII-të (njëzeteshtatë) mandati VII-të i Komitetit për Politikë dhe Financa.

Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit në ndërtesën e re të Komunës, dhe filloi në orën 10;20

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit, përkatësisht i këtij Komiteti.

Fillimisht u konstatua se në mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e këtij Komiteti, dhe atë;

(Naim Çunaku; Qëndrim Softolli; Arnisa Sylejmani; Haki Rudari; Drita Pajaziti; Sebastina Vokri; Bashkim Sylja; Mrika Thaçi - lista e nënshkrimeve.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje të pranishëm ishin edhe; *Shuajb Blakçori U.D. drejtor i Drejtorisë së Administratës-DA; Fatlum Osmani drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave-DBF dhe i Autorizuar për ushtrimin e punëve dhe detyrave nga kompetencat dhe fushveprimtaria e Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë-DPKGJ; Adelina Stublla Drejtoresh e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale-DSHMS; Leutrim Krasniqi drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit-DPUMM; Lirie Hoti drejtoresh e Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural-DBPZHR.*

Po ashtu pjesëmarrës në mbledhje ishte edhe Ekrem Rrahmani, anëtar i Kuvendit të Komunës.

### Rendi i ditës

**z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit**, e hapi mbledhjen përshëndeti të pranishmit, theksoi, për këtë mbledhje është paraparë rendi i ditës prej 9 pikave, kuorum kemi dhe të gjithë anëtarët e KPF-së janë të pranishëm, andaj urdhëroni a dëshiron ndokush fjalën lidhur.

**z.Fatlum Osmani**, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave-DBF dhe i Autorizuar për ushtrimin e punëve dhe detyrave nga kompetencat dhe fushveprimtaria e Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë-DPKGJ, theksoi, më lejoni që për rend të ditës të propozoj 1 pikë nga ana e Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, bëhet fjalë për një transferim të buxhetit nga dy projekte, projekti për ndërtimin e infrastrukturës së varrezave dhe projekti për rindërtimin e rrugëve të asfaltuara, ku nga projekti për infrastrukturë të varrezave të transferohen 100,000.00€ dhe nga projekti për rindërtimin e rrugëve të asfaltuara 150,000.00€, mjetet këto të transferohen në projektin për ndërtimin e rrugës “Xhemajl Mustafa” në vlerë totale 250,000.00€.

Arsyeja e këtij transferimi është procedurale ngase në këto dy projekte ka një ngecje për realizimin e tyre, ndërsa te rruga “Xhemajl Mustafa” për shkak të kontratave kolektive të cilat janë të nënshkruara dhe pasi që kanë rrjedh edhe vendimet gjyqësore për zbatimin e atyre kontratave, pra gjykata ka marr vendim që të ekzekutohen mjetet dhe pastaj Thesari i ka marr mjetet nga projekti i ndërtimit të rrugës “Xhemajl Mustafa”, kështu që e kemi të domosdoshme transferimin e këtij buxheti.

**Kryesuesi i Komitetit**, theksoi, e hedhim në votim propozimin e drejtorit të DBF që të shtohet edhe 1 pikë rendit të ditës që ishte për transferim të buxhetit ashtu siç e prezantoj dhe sipas materialeve të shpërndara tani..

*Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se nga 9 anëtarët e KPF-së, me 6 vota Për, asnjë votë Kundër dhe asnjë votë e Përmbajtur (të tjerët nuk votuan), mbështet që në kuadër të rendit të ditës në këtë mbledhje të përfshihet pika shtesë, dhe atë:*

**Propozim vendimi për transferimin e buxhetit të Komunës për vitin 2024**, sipas materialit përkatës të prezantuar në këtë mbledhje-pikë e tretë e rendit të ditës.

**Kryesuesi i Komitetit**, theksoi, meqë nuk ka të lajmëruar tjerë për të marrë fjalën, tani e hedh në votim rendin e ditës sipas thirrjes dhe materialit përkatës të dërguar, përfshirë edhe pikën shtesë paraprake e cila u përkrah për t'u përfshirë në kuadër të rendit të ditës në këtë mbledhje, dh atë në pikën 3.

*Pas votimi Kryesuesi i Komitetit konstatoi se nga 9 anëtarët e KPF-së, me 6 vota Për, asnjë votë Kundër dhe asnjë votë e Përmbajtur (të tjerët nuk votuan), miratohet rendi i propozuar i ditës sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje, përfshirë edhe pikën shtesë: Propozim vendimi për transferimin e buxhetit të Komunës për vitin 2024, e cila renditet në pikën 3, kurse pikat tjera kalojnë sipas renditjes në vazhdim.*

## **1. Procesverbali nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa e mbajtur më 29.07.2024**

*Njëzëri, pa vërejtje apo plotësim ndryshime, miratohet procesverbali nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa e mbajtur më 29.07.2024, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.*

## **2. Propozim vendimi për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2025**

**z.Fatlum Osmani**, drejtor i DBF dhe i Autorizuar për ushtrimin e punëve dhe detyrave nga kompetencat dhe fushveprimtaria e DPKGJ, e paraqiti fjalën hyrëse, theksoi, në bazë të ligjit për tatim në pronë i cili është i miratuar nga ana e Kuvendit të Kosovës në vitin 2023, Komuna është pjesë e këtij tatimi dhe ky tatim është e hyrë vetanake e Komunës dhe jemi të detyruar që në bazë të ligjit që përcakton normat tatimore për vitin e cili pason, pra bëhet fjalë për vitin 2025.

Ligji për tatim në pronë jep disa limite për këto norma tatimore e që janë minimumi dhe maksimumi i normave tatimore të cilat duhet të aplikohen në vitin 2025, pra është në kompetencën e Kuvendit Komunal që në bazë të ligjit dhe në bazë normave tatimore të cilat i përcakton ligji nga minimumi dhe maksimumi përbrenda këtyre limiteve t'i miratoj normat tatimore të cilat duhet të aplikohen në vitin 2025.

Bazuar në ligj, propozimi i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave është siç e keni parë në propozim vendim ku janë normat minimale të cilat i përcakton ligji i tatimit në pronë, pra ne si propozues dhe ju si Kuvend nuk mundemi të miratojmë norma tatimore më të vogla se që janë të propozuara në këtë propozim vendim

dhe normalisht siç po e shihni edhe në propozim vendim është edhe maksimumi i normave kështu që ne kemi shkuar me minimumin e vlerave tatimore të cilat i përkufizon ligji.

**z.Haki Rudari**, theksoi, ne Grup i LVV e kemi shqyrtuar këtë pikë të rendit të ditës dhe në parim e përkrahim propozim vendimin për caktimin e normave tatimore për vitin 2025, në të njëjtën kohë këtu janë shumat dhe normat në kuadër të shumës dhe nuk e di i nderuar drejtor sa do të kishte të drejtë ligjore që kjo shuma 100,000.00€ që ndoshta ka mund të jetë 50,000.00€, një shumë tjetër e prej 50,000.00€, deri në 100,000.00€, të ketë një normë tjetër, t'ju them të drejtën unë procedurën ligjore nuk e di krejt saktë lidhur me këtë, përndryshe natyrisht se edhe në Kuvend do t'i japim mendimet tona, propozimet dhe do ta përkrahim për arsye se është edhe obligim ligjor.

**z.Bashkim Sylja**, theksoi, dëshiroj një sqarim nga drejtori i DBF-së, tek pika 1.1 është vlera e përcaktuar për pronën deri 100,000.00€ 0.10%, mirëpo pikat tjera shembull 1.2 është mbi 100,000.00€ vlera e caktuar e një shtëpie vlerësohet 0.20% e tatimit dhe plus tatimi që është në paragrafin 1.1 të këtij neni, pra a llogaritet edhe 10% plus apo është statike kjo 20%, pastaj të gjitha pikat tjera që janë mbi 100,000.00€ i bie 0.30%, te pika 1.3 është 30% të tatimit dhe bashkë me pikën 1.1 dhe 1.2, pra i bie 60%, ndërsa pika 1.4 që është mbi 1,000,000.00€ 0.40% që i bie plus 100% të vlerës dhe te pika 1.5 me vlerë mbi 5,000,000.00€ është 50%, prandaj nuk e di sa ka qenë e nevojshme që të bëhet ky përshtjellim dhe të kamuflohet kjo punë sepse është dashtë që të jetë shifra totale dhe jam i bindur që shumica e anëtarëve të Kuvendit nuk e kuptojnë këtë, dhe nuk e di a është minimumi i normës së interesit në bazë të ligjit kjo.

**z.Naim Çunaku**, theksoi, duke u bazuar në atë që është kategori ligjore vendosja e tarifave dhe taksave, ne Grupi i LDK e mbështesim që të kaloj në Kuvend dhe këtë duke e pasur për bazë fjalën e drejtorit të DBF që Komuna jon këtë herë propozon minimumin e mundshëm ligjor dhe përderisa edhe propozimi i LDK është që të shkojmë në minimumin e mundshëm të ngarkesave në taksave dhe tarifave për qytetarët, ndërsa nesër diskutimet tona do t'i japim në Kuvend.

**z.Fatlum Osmani**, drejtor i DBF dhe i Autorizuar për DPKGJ, theksoi, sa i takon vlerave të pronave të cilat janë të tatimuara, pra vlera deri në 100,000.00€ nuk kemi mundësi sepse kështu e përcakton ligji dhe nuk mund të ndryshojmë kategoritë në kuadër të vlerave të pronave, pra ligji e përcakton nga 0.1% deri në 1%, dhe ne kemi shkuar në minimum, kjo nënkupton që nuk mund të ndryshojmë as normën tatimore dhe as vlerën e pronës e cila tatimohet për këtë çështje. Një gjë që e përcakton ligji dhe që nuk është pjesë e vendimit ngase përcaktohet me ligj është që pronat deri në 30,000.00€ nuk tatimohen, pra tatimohen vetëm pronat mbi 30,000.00€.

Çështjet të cilat i shtroj z.Bashkim Sylja, është tatim progresiv dhe se çka nënkupton kjo ju shpjegoj thjesht, një pronë e cila është në vlerë 200,000.00€ tani 100,000.00€ të parat largohet shuma 30,000.00€ pra tatimohet vetëm për 70,000.00€ dhe 0.1% që i bie 70 €, pra nëse vlera e pronës është 200,000.00€ deri në 100,000.00€ ai është tatuar 70 € dhe tani prej 100,000.00€ deri 200,000.00€ bëjnë 100,000.00€, pra vetëm kjo diferenca prej 100,000.00€ tatimohet me 0.2%. Në qoftë se prona është 200,000.00€ kategoria e parë është deri në 100,000.00€ ajo pronë tatimohet duke u zbritur 30,000.00€ që është pragu i kalkulimit të tatimit, ndërsa te pjesa tjetër e diferencës nga pika 1.1 që është 100,000.00€ tatimohet me 0.2%, tani në rast se një pronë ku vlera e saj maksimum është 5,000,000.00€ tatimi llogaritet kështu në mënyrë progresive, pra deri në 100,000.00€ 0.1% kurse pjesa tjetër 0.2% dhe pastaj komplet këto norma që kalkuloohen përbrenda këtyre vlerave apo këtyre shkallëve tatimore mblidhen dhe del tatimi i asaj prone që kalkulohet nga ana e sistemit të menaxhimit të tatimit në pronë, kështu që po e përsërisë që kemi shkuar me minimumin dhe duke pasur parasysh që Ministria e Financave e ka rritur shkallën e tatimit që ka qenë 15.000.00€ tani është 30.000.00€ dhe kjo shkallë tatimore vlen vetëm për banime rezidenciale dhe jo për biznese. Bëhet fjalë për një tatim që qytetarët do t'i nënshtrohen për pronat rezidenciale dhe normalisht vlerësimi bëhet nga ana e Ministrisë së Financave duke u bazuar në zonat e banimit, shembull 5 fshatra

janë përmendur në normë tatimore dhe aty është vlerësimi se sa kushton 1 m<sup>2</sup> e një shtëpie dhe tokës, andaj përbrenda këtyre vlerave apo normave tatimore nxjerrët tatimi në pronë për çdo pronë të qytetarëve.

**z.Naim Çunaku**, theksoi, duke u bazuar në atë që e elaboroj drejtori parafolës, nuk jemi kompetent për të ndryshuar ligjin dhe po ta analizohet dhe të merret si mostër, shembull te fshatrat në Komunën tonë nuk paraqet diçka të madhe por në nivel të Kosove paraqet, shembull ku janë ndërtuar lagjet rezidenciale, dhe nëse merret për bazë se sa është pjesa e atij fshati e që e dini për cilat raste e kam fjalën, dhe atyre njerëzve që janë me banim më të shtrenjtë dhe një banim më luksoz që është në nivel Kosove, mirëpo nuk është në kompetencën tonë por është dikush tjetër që e vlerëson, shembull Lagjja Marigona dhe të tjerat, merret për bazë gjeografikisht sa është tatimi i asaj zone apo fshati, kështu që nuk e konsiderojmë të drejtë por është kështu siç është dhe nuk jemi kompetent ta ndryshojmë.

Edhe njëherë po e them dhe po e përmbylli, neve në këtë situatë ekonomike të cilën e kemi në Kosovë dhe me trendin e zhvillimit ekonomik që kemi nuk mund të votojmë diçka tjetër, përjashtim asaj që e potencoj edhe drejtori i DBF-së që të kalojmë në fazën apo tarifat minimale që qytetari i Komunës të Podujevës t'i paguaj ato.

**Kryesuesi i Komitetit**, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo atëherë e hedhim në votim këtë pikë të rendit të ditës që t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim.

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se Njëzëri me 9 vota Për, kjo pikë e rendit të ditës rekomandohet për shqyrtim në mbledhjen e Kuvendit, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.*

### **3. Propozim vendimi për transferimin e buxhetit të Komunës për vitin 2024**

**z.Fatlum Osmani**, drejtor i DBF-ës dhe i Autorizuar për ushtrimin e punëve dhe detyrave nga kompetencat dhe fushveprimtaria e DPKGJ, e paraqiti fjalën hyrëse, theksoi, unë kur e prezantova si pikë të rendit të ditës i theksova arsyet pse duhet të votohet dhe arsyen pse e kemi propozuar këtë pikë për seancën e radhës të Kuvendit, pra janë dy projekte që e kanë një ngecje për arsye procedurale dhe në anën tjetër e kemi kontratën kolektive nga e cila na janë marr mjetet nga disa projekte dhe tani duhet të bëhet ky transferim i mjeteve nga dy projekte në një projekt tjetër, andaj ju ftoj që ta mbështetni që të kaloj në seancën e Kuvendit.

**Kryesuesi i Komitetit**, theksoi, i nderuar drejtor i DBF-së, kërkoj nëse ka mundësi të kuptojmë se sa është vlera që është marrë nga kontrata kolektive dhe sa jemi dëmtuar deri tani.

**z.Fatlum Osmani**, drejtor i DBF dhe i Autorizuar për DPKGJ, përgjigje Kryesuesit, theksoi, është mbi 3,000,000.00€, nëse nuk gaboj është 3,087,000.00€.

**z.Naim Çunaku**, theksoi, kontrata kolektive nuk e ka dëmtuar askënd sepse ajo është një marrëveshje në mes Sindikatës dhe Qeverisë dhe të gjithë ju që jeni pjesë e asaj kontrate edhe kur nuk ka paguar Komuna keni bërë padi private për kompensim dhe nuk e konsideroj që na ka dëmtuar diçka neve, në fakt na ka dëmtuar forma e zgjedhjes së atij problemi që ka deshtë të rregullohet nga niveli qendror mirëpo nuk mund ta quajmë atë që na ka dëmtuar buxhetin.

Dua t'i kthehem pikës për të cilën e kam marrë fjalën, pra për propozimin e vendimit për transferim të buxhetit, i nderuar drejtor i DBF-së unë jam i interesuar të di tek kodet e ndërtimit të varrezave 54952 sa ka qenë buxhet i planifikuar për këtë kategori kur po i merren 100,000.00€, pra sa ka qenë i planifikuar dhe të njëjtën pyetje e kam edhe për projektin për rindërtimin e rrugëve të asfaltuara në një vlerë 150,000.00€ sa kanë qenë të planifikuara në këtë projekt që po kemi mundësi të marrim këtë pjesë dhe sa përqind nga totali i planifikuar për këto dy kode buxhetore i'u tërhiqen nëse të parës i tërhiqen 100,000.00€ dhe të

dytës 150,000.00€, ndërsa te alokimi i projektit të rrugës “Xhemajl Mustafa” ku për këtë rrugë sa e di unë janë të parapara 1,300,000.00€ dhe a mund flasim që në një projekt që e kemi filluar dhe kemi hyrë me një diferencë apo nuk është planifikuar mirë dhe tani atij projekti duhet t’i shtohen 250,000.00€, pra kjo tregon një planifikim jo të drejtë apo jo të saktë.

**z.Fatlum Osmani**, drejtor i DBF dhe i Autorizuar për DPKGJ, theksoi, te projekti për infrastrukturë në varreza kanë qenë të planifikuara 100,000.00€ dhe propozimi është që të tërhiqen të gjitha këto mjete që janë për infrastrukturë në varreza, arsyeja është prona, hartimi i projektit dhe procedurat e prokurimit ku jemi në gjysmën e muajit shtator dhe është e pamundshme që në këtë fazë të realizohet ky projekt, ndërsa te projekti rindërtimi i rrugëve të asfaltuara kanë qenë të planifikuara 300,000.00€ ku afër 120,000.00€ janë shpenzuar në këtë vit nga kontrata e vitit të kaluar, ndërsa kontrata e vitit të kaluar tashmë i ka përfunduar si kontratë dhe janë ekzekutuar pagesat kurse së fundmi është kontrata e re, pra i ka kaluar fazat e prokurimit dhe në fazën e vlerësimit për arsyeje që operatorët ekonomik nuk i kanë plotësuar kriteret është anuluar si procedurë, tani përsëritja e kësaj procedure që ka qenë me një vlerë 600,000.00€ ose 700,000.00€ nëse nuk gaboj, për periudhë 2 vjeçare siç është planifikuar në prokurim është e pamundshme në kuptimin procedural që të lidhet si kontratë para muajit nëntor dhe pastaj muaji nëntor është i pa përshtatshëm për punimet apo rregullimet në rrugë, kështu që këto mjete buxhetore me një fjalë në këtë projekt nuk mund të shpenzohen, meqenëse në këto dy projekte nuk mund të shpenzohen dhe në rrugën “Xhemajl Mustafa” kemi mungesë për arsyeje të marrjes së parave për shkak të vendimeve gjyqësore ku janë ekzekutuar nga ana e Thesarit të Republikës së Kosovë është e nevojshme që të bëhet ky transferim i mjeteve nga këto 2 projekte në projektin e rrugës “Xhemajl Mustafa”.

**z.Naim Çunaku**, theksoi, e kam edhe një pyetje, a jemi në pajtim me Ligjin mbi menaxhimin e financave publike, kur një projekti 100% i merren mjetet, ndërsa tjetrit i merren 50%, më e sa e kujtoj unë neni 38 i këtij ligji a e lejon këtë gjë.

**z.Fatlum Osmani**, drejtor i DBF dhe i Autorizuar për DPKGJ, theksoi, Ligji për financat publike i përcakton përqindjen se sa mjete mund të tërhiqen nga programi dhe jo nga projekti, shembull në tërheqim mjete nga programi i infrastrukturës publike te Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit ku tërhiqen 250,000.00€ e që e përcakton se me vendim të Ministrit dhe me vendim të Kuvendit Komunal mund të tërhiqen mjetet deri në 15% të vlerës së programit, kështu që kjo përputhet dhe nuk e tejkalon këtë përqindje, mirëpo pastaj me aprovim të qeverisë edhe në qoftë se e tejkalon 15%, është deri 20% nga aprovimi i Qeverisë.

**z.Naim Çunaku**, theksoi, i nderuar drejtor, unë nuk doja të hyja në detaje se çka thotë ligji, e di që deri në 3% është Kuvendi i Komunës kurse mbi këtë përqindje kalon në ato instanca tjera si Ministri, Qeveri dhe Kuvend i Kosovës, mirëpo vetëm deshta të di se a kemi të drejtë që një projekt i cili është hartuar si projekt me prioritet në muajin shtator të vitit 2023 tani të tërhiqni komplet dhe ajo shumë prej 250,000.00€ a e tejkalojnë 3% e buxhetit.

**z.Fatlum Osmani**, drejtor i DBF dhe i Autorizuar për DPKGJ, theksoi, kjo nuk ka të bëjë me 3% të vlerës së buxhetit, bëhet fjalë deri në 5% ku merret vetëm me vendim të Kuvendit dhe nuk shkon fare as te Ministri, ndërsa në momentin që e kalon 5% pastaj kalon në procedura deri në 15% që e aprovon Ministri.

**z.Naim Çunaku**, theksoi, i nderuar drejtor, kjo shifër a e tejkalon kompetencën e Kuvendit Komunal.

**z.Fatlum Osmani**, drejtor i DBF, përgjigje parafolësit, theksoi, jo nuk e kalon.

**znj.Drita Pajaziti**, theksoi, në emër të Grupit të LVV e përkrahim këtë pikë të rendit të ditës që të rekomandohet për mbledhjen e Kuvendit.

**Kryesuesi i Komitetit**, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo atëherë e hedhim në votim këtë pikë të rendit të ditës që t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim.

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 9 anëtarët e KPF-së, me 6 vota Për, asnjë votë Kundër dhe asnjë votë të Përmbajtur (të tjerët nuk votuan), kjo pikë e rendit të ditës rekomandohet për shqyrtim në mbledhjen e Kuvendit, sipas materialit përkatës të prezantuar në këtë mbledhje.*

#### **4. Propozim vendimi për fillimin e hartimit të Planit Zhvillimor të Komunës së Podujevës**

**z.Leutrim Krasniqi**, drejtor i DPUMM, e paraqiti fjalën hyrëse, theksoi, Plani Zhvillimor Komunal përfundon ligjshmërinë në vitin 2025 dhe duke e marr për bazë këtë i propozoj Kuvendit fillimin e procedurave për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal i cili është i përcaktuar prej vitit 2025 deri në vitin 2033 në periudhë 8 vjeçare. Ne e kemi dërguar materialin por për shkak të sinkronizimit që duhet të jetë programi me pjesën e hartimit dhe vlefshmërisë së këtij vendimi, para veti e keni edhe pjesën e materialit ku edhe kohëzgjatja në javë ka pësuar disa ndryshime që të jetë në harmoni me periudhën e hartimit, që do të thotë që është periudha prej 12 muajve ky proces i hartimit si dhe po ashtu lëndët janë të ndara sipas procedurës ligjore për hartimin e këtij Plani, andaj e rekomandoj këtë pikë për Kuvend.

Pra edhe njëherë arsyeja e materialit shtesë të cilin ju e keni para jush është për shkak se tek pjesa e programit kanë ndryshuar disa javë për shkak të harmonizimit të këtyre javëve me pjesën e vendimit të Kuvendit që saktësisht është në nenin 7, pra programi është 12 muaj në kohëzgjatje me pjesën e vlefshmërisë së vendimit.

**znj.Arnisa Sylejmani**, theksoi, në emër të Grupit të LDK-së e përkrahim këtë pikë të rendit të ditës që të vazhdoj për diskutim në Kuvend, sugjerimet dhe vërejtjet tona lidhur me këtë pikë të rendit të ditës do t'i japim nesër.

**znj.Sebastina Vokrri**, theksoi, edhe ne Grup i LVV-së e përkrahim këtë pikë të rendit të ditës dhe i propozojmë Kuvendit për diskutim.

**Kryesuesi i Komitetit**, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo atëherë e hedhim në votim këtë pikë të rendit të ditës së bashku me plotësim ndryshimin e programit të punës për hartimin dhe menaxhimin e Planit Zhvillimor Komunal që u prezantua nga drejtori parafolës.

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se Njëzëri me 9 vota Për, kjo pikë e rendit të ditës rekomandohet për shqyrtim në mbledhjen e Kuvendit, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes si dhe plotësim ndryshimin e Programit të punës për hartimin dhe menaxhimin e Planit Zhvillimor Komunal, prezantuar në këtë mbledhje.*

## 5. Propozim vendimi për miratimin e Planit Rregullues të Hollësishëm për Zonën Industriale në Komunën e Podujevës

**z.Leutrim Krasniqi**, drejtor i DPUMM, e paraqiti fjalën hyrëse, theksoi, ky është hapi i fundit sa i përket miratimit të Planit Rregullues të Hollësishëm të Zonës Industriale, po ashtu pas përfundimit të procedurave siç janë të përcaktuara me legjislacion në fuqi rreth procesit së hartimit ku është edhe dërguar materiali tek ju përmes e-mailit dhe përmes CD për shkak të volumit të madh të këtij materiali, andaj e rekomandoj këtë pikë të rendit të ditës të kaloj për shqyrtim në Kuvend.

**z.Haki Rudari**, theksoi, ne Grupi i LVV e përkrahim propozim vendim për miratimin e Planit Rregullues të Hollësishëm për Zonën Industriale në Komunën e Podujevës dhe normalisht në Kuvend do të shqyrtohet më në detaje.

**z.Bashkim Sylja**, theksoi, sa i përket kësaj pike dhe rëndësisë që e ka kjo pikë e rendit të ditës kam pritur që drejtori i DPUMM do të na ftoj në një takim që të na shpjegoj në mënyrë më të mirë dhe të na informojë se çka është punuar sepse shumica prej neve nuk jemi ekspert të kësaj fushe, kështu që do të ishte një ndihmesë shumë e madhe nëse drejtori i Drejtorisë në fjalë nesër në seancën e Kuvendit të bëjë një prezantim të shkurtër të punës që është bërë sepse do të ishte më korrekte dhe do të informohemi më mirë të gjithë ne.

**z.Leutrim Krasniqi**, drejtor i DPUMM, theksoi, sa i përket anës time nuk do të ketë problem fare dhe nëse kërkoni një lloj prezantimi ndoshta më të shkurtër rreth Zonës Industriale, koncepti i zhvillimit e kështu me radhë edhe pse në këtë rast do të ishte më e nevojshme nga ana e juaj që të jeni pjesë e diskutimeve publike kur i kemi pasur rreth Zonës Industriale sepse në atë fazë ka qenë pjesa ku edhe ju ndoshta do të kishit pasur mundësi të kontribuoni në pjesën e planifikimit të kësaj zone.

**z.Bashkim Sylja**, theksoi, i nderuar drejtor i DPUMM, ne kemi kontribuar sa i përket kësaj çështje dhe kemi miratuar shumë vendime që janë për Zonën Industriale siç janë shpronësimet e tokave, ndarja e mjeteve e të tjera, mirëpo ne ekspert të asaj fushe nuk jemi dhe një prezantim ke mund ta bësh dhe ke pasur mundësi që të na thirrësh edhe pas seancës, unë këtë jam duke e thënë për qëllimin më të mirë rreth punës që e ke bërë ti, përndryshe edhe po të isha në atë takim unë nuk do të mund të ndërhyja sepse nuk e di se cila pikë është më mirë se tjetra, kështu që unë e kisha me qëllimin më të mirë që ne të informohem për punën që e ke bërë ti rreth Zonës Industriale.

**z.Leutrim Krasniqi**, drejtor i DPUMM, theksoi, gjithsesi unë nuk e mohoj kontributin e juaj në këtë rast mirëpo meqë u përmend si qytetarë dhe si anëtarë i Kuvendit në këtë rast që të shihni procesin se si ka shkuar, qoftë ndonjë propozim i cili ndoshta nuk do të ishte adekuat por i cili do të mund të analizohej për një përfundim sa më të mirë, po e përsërisë nga ana ime nuk është problem dhe mundem që brenda ditës të përgatiti një prezantim të shkurtër për këtë pjesë në qoftë se ju e konsideroni të nevojshëm sa i përket situatës dhe procesit të miratimit të Zonës Industriale. E kuptoj që për Podujevën aktualisht është projekti më i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik, kështu që sipas asaj që ju e vlerësoni nëse e vendosim që nesër të bëhet një prezantim i shkurtër dhe nuk do të kishte asnjë problem për këtë.

**z.Naim Çunaku**, theksoi, rreth kësaj që u hap si temë në kuptimin e njohurive me të gjera gjegjësisht involvimin e këshilltarëve në ngjarje duke u bazuar në atë që e theksoi kolegu z.Bashkim Sylja që vërtetë anëtarët e Kuvendit që mund të jen apo jo profesionist të fushës dhe një praktik e mirë që do të duhej të ndodhte që prej miratimit të Hartës Zonale ku në këto raste kur kemi dokumente strategjike që përcaktojnë një të ardhme të zhvillimit të Komunës sonë do të ishte një praktikë e mirë.

E di që nuk e obligon ligjërisht dhe jo të thirremi në atë që kemi mundur të japim kontributin gjatë diskutimeve publike, mirëpo do të ishte shumë e nevojshme dhe produktive të paktën do të pajisen të gjithë me ide dhe me njohuri specifike që ndërthen në vete një Plan i cili pretendohet që të bëhet, të organizohen punëtori me Kuvendin dhe Ekzekutivin dhe do të ishte mirë që të gjithë të japin një kontribut

për një dokument sa më të mirë, për një dokument final i cili do të bënte një përcaktim sa më të saktë dhe orientim zhvillimor të Komunës së Podujevës, në këtë formë përkrahja siç e tha z.Bashkim Sylja është bërë mirëpo nuk pengon ana ligjore, përkundrazi do të ishte më mirë që këto dokumente të natyrës dhe rëndësisë së këtij lloji që të bëhet praktikë të organizohen punëtori mes Ekzekutivit dhe Kuvendit në mënyrë që të nxirret më e mira.

**Kryesuesi i Komitetit**, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo atëherë e hedhim në votim këtë pikë të rendit të ditës që t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim.

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 9 anëtarët e KPF-së, me 6 vota Për, asnjë votë Kundër dhe asnjë votë të Përmbajtur (të tjerët nuk votuan), kjo pikë e rendit të ditës rekomandohet për shqyrtim në mbledhjen e Kuvendit, sipas materialit & CD përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.*

## **6. Propozim vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-437-1, ZK Podujevë**

### **6.1. Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim**

**z.Fatlum Osmani**, drejtor i DBF dhe i Autorizuar për ushtrimin e punëve dhe detyrave nga kompetencat dhe fushveprimtaria e DPKGJ, e paraqiti fjalën hyrëse, theksoi, meqenëse bëhet fjalë për 5 pika të rendit të ditës të cilat pothuajse janë të një natyre, faktikisht unë propozoi që të kalojnë për diskutim dhe miratim në seancën e Kuvendit në pako pikat e rendit të ditës të renditura nga 6 deri në 10.

**z.Naim Çunaku**, theksoi, edhe ne e përkrahim që të bashkohen pikat, mirëpo vërtetë ka qenë mirë të përmenden në fillim të seancës që të bashkohen dhe do t'i trajtonim si tërësi sepse afërsisht janë të njëjtës peshë dhe të njëjtës natyrë dhe shkak i kohës të trajtohen në mënyrë të përbashkët që të gjitha.

**z.Bashkim Sylja**, theksoi, edhe unë jam për që të bashkohen pikat në fjalë dhe të shqyrtohen në pako në këtë mbledhje të KPF-së, mirëpo nuk e di se a ka aplikuar ndonjë nga shoqëria civile lidhur me komisionet vlerësuese në mënyrë që të jepen këto prona në shfrytëzim.

*Pas paraqitjes së fjalës hyrës dhe diskutimeve për pikat e rendit të ditës të renditura në vijim, Kryesuesi i Kuvendit / KPF-së i hedh në votim të shqyrtohen në pako, sipas materialeve përkatëse dërguar me thirrjen e mbledhjes,*

*Njëzëri mbështetet që të shqyrtohen në pako pikat e renditura nga pika 6 deri në 10, si në vijim:*

## **6. Propozim vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-437-1, ZK Podujevë**

### **6.1. Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim**

## **7. Propozim vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësitë kadastrale P-704-0 dhe P-706-0, ZK Llapashticë e Poshtme**

### **7.1. Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim**

## **8. Propozim vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-1615-4, ZK Orllan**

### **8.1. Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim**



**9. Propozim vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-1119-0, ZK Balloc**

**9.1. Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim**

**10. Propozim vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-1057-0, ZK Balloc**

**10.1. Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim**

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit / KPF-së konstatoi se Njësëri me 9 vota Për, pikat renditura nga 6 deri 10 sipas rendit të ditës, rekomandohen për shqyrtim në mbledhjen e Kuvendit, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.*

*Kryesuesi i Komitetit e konstaton të përfunduar këtë mbledhje.*

**Mbledhja përfundoi në orën 11:00**

**Procesverbalin e mbajtën dhe hartuan;**

**Enis Sheholli**

**Arbrim Idrizi**

**Nr.Prot.01-060/04-0061766/24**  
**Podujevë, 11 shtator 2024**

**Kryesuesi i Kuvendit - Komitetit**  
**Hilmi Hoxha**